



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA GJIROKASTËR
KËSHILLI I BASHKISË

V E N D I M
Nr. 13 Datë 27.02.2024
PËR

**“AUTORIZIMIN E BASHKISË GJIROKASTËR PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE
PËR KALIMIN NË PRONËSI TË PRONËS SË PALUAJTSHME ME EMËRTIMIN
SHTËPIA E OFICERAVE (KATI I DYTË DHE I TRETË) QË DO TË PËRDORET PËR
USHTRIMIN E DETYRAVE TË SAJ FUNKSIONALE ”**

Në mbështetje të nenit 8 pika 2, nenit 9 pika 1, nënpika 1.1, shkronja “b” dhe nënpika 1.2 ; nenit 25; nenit 55 pika 2 dhe 6, Ligjit Nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar; Ligjit Nr.8743 datë 22.02.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit” të ndryshuar, nenit 3 pika d) të Ligjit Nr.8744 datë 22.02.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, pikës 6 dhe pikës 14, paragrafi i dytë i vendimit Nr.500, datë 14.08.2001 të Këshillit të Ministrave “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, pikës 1, shkronja “a”, të Udhëzimit Nr.15, datë 30.06.2003, të Ministrit të Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit “Për mënyrën e paraqitjes nga njësitë e qeverisjes vendore të kërkesave për transferimin në pronësi të tyre të pronave të paluajtshme publike”, me propozimin e Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak në mbledhjen e datës ____/____/2024 ;

V E N D O S I :

1. Të autorizojë bashkinë Gjirokastrë për fillimin e procedurave për kalimin në pronësi të Bashkisë Gjirokastrë të “Shtëpisë së Oficerave”, kati i dytë dhe i tretë, me vendndodhje lagjia “18 shtatori”, Zona kadastrale 8541, me numër pasurie 24/15 dhe indeks harte Gj- F7, 67, Lloji i pronës ndërtesë.
2. Ngarkohen Drejtoria Juridike dhe e Prokurimeve Publike, Drejtoria e Trashëgimisë, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Drejtoria e të Ardhurave, Pronave Publike, Lejeve dhe Licensave dhe Drejtoria e Urbanistikës për zbatimin e këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas miratimit të tij.

SEKRETAR I KËSHILLIT

Etleva Yzo

KRYETARI I KËSHILLIT

Merita Isaraj